



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

**Raport përfundimtar për auditimin e “Sistemeve të teknologjisë së informacionit”
ushtruar në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara**

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

PËR

AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

NË AGJENCINË E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE

TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA

Tiranë, korrik 2025

PËRMBAJTJA

Nr.	EMËRTIMI	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-4
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	4
II.	HYRJA	
1.	Objektivat dhe qëllimi	5
2.	Identifikimi i çështjes	5
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	5
4.	Përgjegjësitë e audituesve	5-6
5.	Kriteret e vlerësimit	6
6.	Standardet e auditimit	6
7.	Metodat e auditimit	6
8.	Dokumentimi i auditimit	6
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	
1.	Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	7
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	
2.1	Krijimi, mirëmbajtja dhe zhvillimi i aseteve të Teknologjisë së Informacionit	7-11
2.2	Auditimi i sistemeve informatike mbi të dhënat Input/Output	11-15
IV.	REKOMANDIME	16-19

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

KLSH mbështetur në Ligjin nr.154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, zhvilloi auditimin mbi Teknologjinë e Informacionit në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, nga data 20.03.2025 deri në 14.05.2025.

Grupi i auditimit, pasi mblodhi informacione të mjaftueshme, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë mbi të cilat hartoi drejtimit e auditimit.

Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Auditimi me objekt “Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit”, në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara - AAPSK, është pjesë e Planit Vjetor të auditimit për vitin 2025, miratuar nga Kryetari i KLSH-s.

Përzgjedhja e këtij subjekti është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH ka vlerësuar të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit, që ka në përdorim AAPSK. Pas marrjes së ambienteve të përshtatshme, grupi auditues filloi fazën e studimit paraprak, ku u dërgua pyetësori i hartuar nga grupi i auditimit, bazuar në Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit. Programi i auditimit është miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 275/1, me datë 20.03.2025 dhe përfundimi i tij në terren përfundoi brenda afatit të përcaktuar në program.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Paraqitja e gjetjeve kryesore:

- Nga auditimi u konstatua se në AAPSK mungon dokumentacioni bazë rregullues dhe teknik për teknologjinë e informacionit mbi të cilën mbështetet aktiviteti i institucionit, që përfshin:
 - Rregullore për përdorimin dhe menaxhimin e infrastrukturës së TI-së;
 - Dokumentimin e arkitekturës dhe konfigurimit të infrastrukturës teknologjike;
 - Kategorizimin e informacionit të gjeneruar dhe të ruajtur nga institucioni si dhe procedurat për ruajtjen e të dhënave;
 - Menaxhimin e aseteve të teknologjisë së informacionit dhe të përdoruesve;
 - Përcaktimin e pikave të kontaktit për trajtimin e problematikave që hasin përdoruesit.

Mungesa e këtyre dokumenteve kufizon qartësinë operationale, vështirëson mirëmbajtjen dhe garantimin e sigurisë, si dhe cenon ruajtjen e historikut dhe auditueshmërinë e sistemeve informatike, dhe në kundërshtim me kërkesat e standardit ISO/IEC 27001.

- Nga auditimi është konstatuar se, në mungesë të IT si strukturë në institucion apo suportit nga IT e Ministrisë së Brendshme/AKSHI, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, nuk ka patur një suport të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm për problematika të teknologjisë së informacionit, duke u mbështetur kryesisht në njohuritë bazë të punonjësve për menaxhimin e aseteve TIK. Kjo situatë cenon sigurinë, integritetin dhe efikasitetin e proceseve të automatizuara të punës, duke rritur mundësinë e gabimeve njerëzore, konfigurimeve të pasakta dhe vonesave në adresimin e incidenteve. Aktualisht për problematika në fushën TIK institucioni suportohet nga specialisti për dixhitalizimin e arkivës së AAPSK me kontratë të përkohshme 1 (një) vjeçare, në zbatim të vendimit nr. 395, datë 29.4.2015 “Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike”.

- Sistemi elektronik për menaxhimin e regjistrit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara - SPSK, është regjistruar si bazë të dhënash shtetërore me VKM nr. 835, datë 28.10.2020. Ky sistem është instaluar nga AKSHI në vitin 2019, me mirëmbajtje për 4 vjet (kontratë e klasifikuar), dhe AAPSK nuk disponon asnjë informacion mbi afatet, kriteret dhe vlerën e

zbatimit të kësaj kontrate. Mos përdorimi i këtij sistemi është konstatuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe në Auditimin e Përputhshmërisë ku është rekomanduar vënia në përdorim dhe përditësimi i regjistrit elektronik të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, publikuar në linkun:

<https://www.klsh.org.al/raport-perfundimtar-per-auditimin-e-ushtruar-ne-agjencine-e-administrimit-te-pasurive-te-sekuestruara-dhe-te-konfiskuara/>.

Gjatë periudhës objekt auditimi, ky sistem nuk qenë funksional dhe nuk është përdorur në praktikë për kryerjen e proceseve të administrimit të pasurive.

Punonjësit e AAPSK-së kanë përcjellë tek AKSHI probleme të rëndësishme dhe të vazhdueshme të mosfunksionimit të sistemit, megjithatë situata vazhdon të jetë e njëjtë.

Gjatë periudhës objekt auditimi, punonjësit e agjencisë kanë vijuar të punojnë për regjistrimin dhe menaxhimin e të dhënave të regjistrit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara me tabela Excel si një mënyrë alternative, për arsye të problematikave që kanë penguar jo vetëm përdorimin dhe administrimin e tij, por dhe në qasjen në informacion të subjekteve sipas përcaktimeve në VKM nr. 835, datë 28.10.2020.

Për sa më lart, fondet e investuara për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit elektronik emërtuar “regjistri i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”, janë pa efektivitet dhe efikasitet.

Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

- Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara në bashkëpunimin me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, të hartojë dhe miratojë dokumentacionin bazë rregullues dhe teknik për teknologjinë e informacionit ku bëjnë pjesë rregullore, infrastruktura, kategorizimi dhe ruajtja e të dhënave, menaxhimin e aseteve të teknologjisë së informacionit si dhe pikat e komunikimit për trajtimin e problematikave të një niveli më të avancuar teknik.
- Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të marrë masa për miratimin e një strukture të përhershme për teknologjinë e informacionit, si dhe të bashkëpunojë me Ministrinë e Brendshme dhe Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për mbështetje të strukturave të IT-së, për zgjidhjen në kohë dhe me profesionalizëm të problematikave që lidhen me teknologjinë e informacionit.
- Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara si Autoritet Përfitues, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit si Autoritet Kontraktor, të marrin masa për zgjidhjen e mangësive funksionale të vazhdueshme dhe vënien në funksion të sistemit elektronik për regjistrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, përkatësisht ISSAI 100, ISSAI 5300 dhe ISSAI 5310, Manualin e Auditimit IT, si dhe në nenet 3 dhe 14 të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, auditimi evidentoi mangësi në dokumentacionin rregullator dhe teknik, në strukturën e dedikuar për menaxhimin e IT-së, si dhe mbështetja e kufizuar teknike, të cilat krijojnë rreziqe për qëndrueshmërinë e proceseve në institucion. Përdorimi i pajisjeve kompjuterike me akses të plotë administrativ, mungesa e antiviruseve, dhe dokumentimi i paplotë i aseteve TIK paraqesin rreziqe për sigurinë dhe kontrollin e informacionit.

Për shkak të problemeve të vazhdueshme teknike në sistemin elektronik të regjistrit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, punonjësit kanë përdorur Excel si mjeti alternativ, për të vijuar me veprimet operacionale që kanë të bëjnë me administrimin e pasurive. Për këto të dhëna mungon një kopje rezervë periodike për të dhënat që gjenden lokalisht në çdo kompjuter, çfarë përbën një risk të disponibilitetit të të dhënave, vazhdimësinë operacionale dhe administrative të agjencisë.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të programit nr. 275/1 prot., datë 20.03.2025, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 20.03.2025 deri më datë 14.05.2025, në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, u krye auditimi mbi teknologjinë e informacionit, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. E. C., përgjegjëse grupi;
2. A. M., anëtare;
3. J. E., anëtare.

1. Objektivat dhe qëllimi

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, zhvilloi auditimin e teknologjisë së informacionit në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, nga data 20.03.2025 deri më datë 14.05.2025. Kërkesat për informacion sipas drejtimeve të programit të auditimit, u hartuan në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

Objekti i Auditimit TIK është përcaktimi nëse objektivat e AAPSK arrihen në mënyrën e duhur duke përdorur burimet IT, përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, konfidencialitetin, integritetin si dhe disponueshmërinë e informacionit që gjenden në të.

Qëllimi i Auditimit TIK është vlerësimi nëse ekzistojnë kontrollet dhe mekanizmat e duhur me qëllim krijimin, mirëmbajtjen, zhvillimin e burimeve IT dhe funksioneve të AAPSK.

2. Identifikimi i çështjes

Drejtimet e këtij auditimi janë bazuar në programin me nr. 275/1, me datë 20.03.2025:

1. Krijimi, mirëmbajtja dhe zhvillimi i aseteve të Teknologjisë së Informacionit;
2. Auditimi i sistemeve informatike mbi të dhënat Input/Output.

3. Përgjegjësitë e subjektit të audituar

AAPSK është një institucion buxhetor, aktualisht në varësi të Ministrisë së Brendshme dhe drejtohet nga Kryeadministratori, i cili emërohet nga Ministri i Brendshëm dhe përgjigjet para tij për mbarëvajtjen e punës së kësaj agjencie. Kryeadministratori si drejtues dhe përfaqësues i AAPSK-së, drejton, organizon, përfaqëson dhe raporton sipas dispozitave ligjore përpara Ministrinë të Brendshme dhe Komitetit Këshillimor Ndërinstitucional të Ekspertëve për masat kundër financimit të terrorizmit. Ai gjithashtu kontrollon punën e administratorëve nëpërmjet raportimeve periodike, i paraqet gjykatës listën e ekspertëve për administrimin e pasurive, lidh kontratën e punës me administratorin 30 ditë pas emërimit me vendim gjykate, raporton për mbarëvajtjen e institucionit, problematikat, të ardhurat e realizuara dhe shpenzimet e kryera për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, përgjigjet për përgatitjen e raportit vjetor të administrimit të pasurisë, përfaqëson AAPSK-në në raport me të tretët etj. Përveç Kryeadministratorit në përbërje të AAPSK-së ka edhe specialist të fushave të ndryshme, me qëllim realizimin e funksionit të kësaj agjencie, që është miradministrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

4. Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit e KLSH-së kanë përgjegjësi në vlerësimin objektiv dhe profesional e të pavarur, nëse ekzistojnë kontrollet dhe mekanizmat e duhur me qëllim krijimin, mirëmbajtjen, zhvillimin e burimeve IT në AAPSK. Për këtë, nga grupi i auditimit me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban programi i auditimit nr. 275/1 Prot., datë 20.03.2025 miratuar nga Kryetari i KLSH-s. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në

bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit të teknologjisë së informacionit si dhe legjislacionin e fushës në të cilën operon AAPSK. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese është siguruar një evidencë e përshtatshme e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

5. Kriteret e vlerësimit

Kriteret ligjore, rregullative dhe standardet mbi të cilat është mbështetur auditimi, janë si më poshtë:

- Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr.34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” (ndryshuar me Ligjin nr. 19/2020, datë 05.03.2020);
- Ligji nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike”;
- VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit”, i ndryshuar me vendim nr. 36, datë 24.1.2018 , me vendim nr. 448, datë 26.7.2018, me vendim nr. 872, datë 24.12.2019;
- VKM nr. 835, datë 28.10.2020, “Për rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, si dhe për përcaktimin e organeve publike apo subjekteve, që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij”;
- Rregullorja e brendshme në AAPSK me nr. 1371/1, datë 07.06.2022;
- Rregullorja e brendshme në AAPSK me nr. 5573/3, datë 09.01.2025.

6. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Kodin Etik, Standardet dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë dhe të qartë.

Standardet e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit që kanë shërbyer si kriter vlerësimi janë: ISSAI 5300, ISSAI 5310, ISO/IEC 27001:2022 dhe ISO/IEC 27002:2022.

7. Metodatat e auditimit

Metodat mbi auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur, janë si më poshtë:

- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullatorë të institucionit dhe sistemit informatik;
- Pyetësorë drejtuar institucionit;
- Intervista zhvilluar me personat përgjegjës.

8. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH, si dhe në manualin e auditimit të Teknologjisë së Informacionit, në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, të dhëna dhe informacione të ndryshme të gjeneruara nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara – AAPSK, është një institucion buxhetor, aktualisht në varësi të Ministrisë së Brendshme dhe drejtohet nga Kryeadministratori, i cili emërohet nga Ministri i Brendshëm dhe përgjigjet para tij për mbarëvajtjen e punës së kësaj agjencie.

AAPSK është institucioni përgjegjës për administrimin dhe/ose përdorimin e pasurive të sekuestruara me vendim të dhënë nga organet e sistemit të drejtësisë apo organet administrative, administrimin dhe/ose përdorimin e pasurive të konfiskuara, si dhe ruajtjen e provave materiale apo administrimin e tyre, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Funkcioni i institucionit është të rrisë të ardhurat nga portofoli i pasurive që ka nën administrim, si dhe të ndërjegjësojë publikun e gjerë mbi rëndësinë e të drejtave/oportuniteteve që përftohen nga administrimi i këtyre pasurive dhe të ardhurave që gjenerohen prej tyre. Ky institucion përbën një hallkë kyçe sepse është i vetmi institucion që shërben si urë lidhëse midis organeve të drejtësisë dhe shoqërisë (biznese apo individë), për çështje që i takojnë menaxhimit të pronës së sekuestruar dhe/ose konfiskuar.

Auditimi kishte si synim vlerësimin e përputhshmërisë me kërkesat ligjore e rregullative në lidhje me krijimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e aseteve të Teknologjisë së Informacionit, si dhe të dhënat Input/Output në sisteme informatike, që disponon apo përdor AAPSK.

2 Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Krijimi, mirëmbajtja dhe zhvillimi i aseteve të Teknologjisë së Informacionit

Në zbatim të pikës 1 “Krijimi, mirëmbajtja dhe zhvillimi i aseteve të Teknologjisë së Informacionit”, u shqyrtua, si më poshtë:

- Ligji Nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” (ndryshuar me Ligjin Nr. 19/2020, datë 05.03.2020);
- VKM nr. 835 datë 28.10.2020 “Rregullat për përmbytjen, formën e regjistrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, si dhe për përcaktimin e organeve publike apo subjekteve, që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij”;
- Struktura organizative;
- Inventari vjetor për mallra dhe materiale;
- Rregullore e brendshme;
- Raport vjetor 2024;
- Pyetësorët dërguar drejt AAPSK-së;
- Intervista të drejtpërdrejta me punonjësit;
- Kontrata e përkohshme e punës për specialistin e dixhitalizimit të arkivës dhe administrator i sistemit të pasurive.

Në epokën e transformimit digjital, asetet e Teknologjisë së Informacionit (TI) përfaqësojnë një komponent thelbësor për funksionimin efikas, të sigurt dhe të qëndrueshëm të çdo institucioni publik. Menaxhimi i duhur i këtyre aseteve, që nga krijimi, mirëmbajtja deri te zhvillimi i vazhdueshëm i tyre është vendimtar për garantimin e cilësisë së shërbimeve, ruajtjen e të dhënave dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe standardeve të sigurisë.

Objektivi i auditimit të krijimit, mirëmbajtjes dhe zhvillimit të aseteve të Teknologjisë së Informacionit është të vlerësojë nëse këto procese menaxhohen në mënyrë efektive, të sigurt dhe në përputhje me rregulloret e institucionit. Auditimi synon të identifikojë dobësi, rreziqe dhe

mundësi për përmirësim në menaxhimin e aseteve IT, për të siguruar vazhdimësinë dhe sigurinë e proceseve të punës.

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara (AAPSK) është institucioni përgjegjës për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, duke vepruar si hallkë lidhëse midis organeve të drejtësisë dhe shoqërisë, në funksion të rritjes së të ardhurave dhe ndërgjegjësimit publik mbi përdorimin e tyre. Organizimi dhe funksionimi për të gjithë stafin e agjencisë gjatë periudhës objekt auditimi është rregulluar, ndër të tjera, me rregulloren e brendshme të institucionit nr. 1371/1, datë 07.06.2022. Në vitin 2025, është miratuar rregullorja e re, me urdhrin Nr.01, datë 07.01.2025 për organizimin dhe funksionimin e AAPSK-së.

Në nenin 33 të ligjit nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, ndryshuar me ligjin nr. 19/2020, datë 5.3.2020, citohet se:

- Për administrimin dhe inventarizimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, krijohet regjistri elektronik i pasurive të sekuestruara e të konfiskuara;
- Regjistri elektronik i pasurive të sekuestruara e të konfiskuara administrohet nga Agjencia, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi;
- Këshilli i Ministrave miraton rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara dhe përcakton organet publike apo subjektet që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij.

Në zbatim të këtij ligji është miratuar VKM nr. 835, datë 28.10.2020, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e Regjistrimit Elektronik të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (SPSK)”, e cila specifikon përmbajtjen, formën, funksionimin, si dhe organet publike apo subjektet që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij.

Sistemi për regjistrin elektronik të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara dhe administrimin e tyre, i quajtur Sistemi i Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara – SPSK, nuk është i regjistruar si aset i institucionit, pasi ky sistem është prokuruar dhe kontraktuar nga AKSHI.

Sipas raportit vjetor për vitin 2024, me vendim të komitetit Ndërinstitucional Nr. 78, datë 23.11.2022, nga të ardhurat e krijuara nga shitja e pasurive të konfiskuara me ankand nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, kanë kaluar 125,000,000 lekë për përdorim të agjencisë, nga të cilat 42,000,000 lekë për investime për “Rikonstruksion zyrash dhe blerje pajisjesh” për AAPSK, specifikisht investim në pajisje TIK në vlerën 9,364,976 me TVSh. AAPSK aktualisht disponon 37 kompjuterë, 16 printerë dhe një pajisje multifunksionale (fotokopje, skanim dhe printim për gjithë personelin). Këto pajisje janë regjistruar në inventarët vjetore për mallra dhe shërbime, si dhe në kartelat personale të punonjësve që i kanë në përdorim. Dorëzimi i pajisjeve në rastet e largimit nga puna behet me procesverbal.

AAPSK disponon licencat e sistemeve të operimit Windows 11 pro/Active, për të cilat ofrohet suport dhe përditësime nga Microsoft. Agjencia, për të siguruar informacionin e kërkuar gjatë auditimit mbi licencat e Microsoft Office, ju drejtua AKSHI-t me shkresën nr.1748 prot., datë 09.04.2025. Në kthim përgjigjen me nr.1604/1 prot., datë 18.04.2025, AKSHI shprehet se e ka pajisur institucioni me 45 paketa Office Pro.


Në zbatim të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, si dhe në përputhje me inventarizimin e aseteve të AAPSK, sipas procesverbalit me nr. 5734/1, datë 31.12.2024, AAPSK ka hartuar listën e aseteve për t’u vlerësuar, midis tyre asetet TIK si: kompjuterë dhe printerë.

Titullari i institucionit ka nxjerr urdhrin nr.165,datë 24.02.2025 “Për ngritjen e komisionit për vlerësimin e aktiveve” dhe në bazë të procesverbalit së vlerësimit, sipas llojit të aseteve dhe veçorive të tyre, në vijim do të ngrihen komisionet e asgjësimit përkatëse.

Nga auditimi u konstatua se licencat në përdorim të Microsoft Office nuk rezultojnë në regjistrat qendror të aseteve apo kartelat personale ku janë instaluar. Për më tepër, numri i licencave të siguruara nga AKSHI prej 45 në total, tejkalon numrin e pajisjeve kompjuterike që disponon AAPSK prej 37 kompjuterë në total. Në regjistrat qendror të aseteve nuk rezultojnë të regjistruar rrjeti fizik dhe as router e switch, si pajisje konfigurimi të networkut në AAPSK.

Gjithashtu, AAPSK disponon faqen zyrtare web të institucionit: aapsk.gov.al.

Fig. 1: Website zyrtar i AAPSK



Burimi: AAPS

Website është i konceptuar si një faqe informuese, e cila pasqyron aktivitetin e institucionit dhe përditëson informacionin publik për të gjitha palët e interesit. Faqja hostohet pranë AKSHI-t. Bazuar në përgjigjet e pyetësorit të nisur me email më datë 02.04.2024 nga grupi i auditimit, punonjësit shprehen se nuk kanë informacion nëse faqja është aktualisht në proces mirëmbajtje, duke qenë se këtë proces e administrojnë AKSHI. Publikimet në faqen web kryhen nga stafi përgjegjës në AAPS. Në takimin e zhvilluar me përfaqësuesen e AKSHI-t, më datë 10.04.2025 u kërkua informacion mbi çështjet e mësipërme së bashku me pika të tjera, që përfshinin mungesën e suportit të vazhdueshëm nga struktura TIK e AKSHI-t pranë Ministrisë së Brendshme ndaj AAPS, informacion mbi mirëmbajtjen e aseteve TIK, ku përfshihet faqja web etj. Për këto pika grupit të auditimit nuk ju sigurova informacion nga AKSHI.

Në mungesë të një strukture të brendshme të Teknologjisë së Informacionit, AAPS i është drejtuar në mënyrë të vazhdueshme IT-së së Ministrisë së Brendshme, për të cilat kjo strukturë nuk është përgjigjur çdo herë që ka qenë e nevojshme. Sipas informacionit të marrë nga vetë stafi i institucionit, AAPS nuk përfiton asistencë të vazhdueshme dhe as mbështetje të strukturuar, qoftë edhe rast pas rasti, nga struktura e IT-së së Ministrisë së Brendshme për zgjidhjen e problematikave që lidhen me asetet TIK. Nga shqyrtimi i komunikimeve elektronike midis AKSHI-t dhe AAPS-së, kjo e fundit ka kërkuar asistencë me sigurimin dhe instalimin e paketës Microsoft, Office 2019. Kjo kërkesë, dërguar me email-in në nëntor 2023, është pasuar nga disa rikujtesa që institucioni ka bërë drejtuar AKSHI-t, përkatësisht ajo me email-in e datës

19.12.2023, email-in e datës 05.02.2024 dhe me email-in e datës 16.05.2024, me qëllim marrjen në konsideratë të kërkesës dhe ofrimin e asistencës së kërkuar. Në 16.05.2024 specialisti i drejtorisë së sistemeve e-Gov pranë AKSHI-t, i përgjigjet emailit duke udhëzuar që AAPSK të kontaktoj punonjësen IT në Ministrinë e Brendshme.

Mungesa e suportit në fushën TIK ka sjellë një boshllëk funksional në trajtimin e çështjeve teknike, duke bërë që vështirësitë e hasura nga punonjësit të mbeten të pa adresuara në kohë dhe shpesh të mos marrin zgjidhje të përshtatshme. Si rezultat, institucionit i mungon kapaciteti për të garantuar funksionimin e qëndrueshëm të pajisjeve dhe sistemeve të informacionit, duke e ekspozuar atë ndaj rreziqeve kibernetike.

Me qëllim përfitimin e një suporti të vazhdueshëm në vijimësi të procesit të dixhitalizimit të arkivës, si dhe zgjidhjes së problematikave të përditshme të IT-së të cilat janë jashtë kompetencave profesionale të pjesës tjetër të stafit, në zbatim të vendimit nr. 395, datë 29.4.2015 “Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike”, për programet kombëtare të praktikave në punë për të rinj, urdhrin të brendshëm nr. 78, datë 04.02.2025 “Për fillimin e marrëdhënieve financiare” dhe kontratës së përkohshme të punës nr. 442 prot., datë 31.01.2025, AAPSK ka nisur marrëdhëniet financiare me afat 1 (një) vjeçar me praktikanten pjesë e programit kombëtar të sipërcituar, në pozicionin specialist për dixhitalizimin e arkivës së AAPSK dhe administrator i sistemit të pasurive. Bazuar në përshkrimin e punës specialisti ka përgjegjësitë si më poshtë vijon:

- Dixhitalizimin e arkivës së AAPSK;
- Administratore e sistemit të regjistrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara;
- Në ndihmë të problemeve të IT për AAPSK;
- Për detyra shtesë të ngarkuara nga Kryeadministratorja në përputhje me rregulloren e brendshme të AAPSK.

Nga auditimi u konstatua se AAPSK nuk ka patur një suport të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm për problematika të ndryshme në teknologjinë e informacionit, duke u mbështetur në njohuritë bazë të punonjësve për menaxhimin e aseteve TIK. Kjo situatë rrit mundësinë e gabimeve njerëzore, konfigurimeve të pasakta dhe vonesave në adresimin e incidenteve duke rrezikuar vijueshmërinë e proceseve të punës.

Nga auditimi u konstatua se të gjithë përdoruesit i aksesojnë kompjuterët si administrator lokal, me të drejta të plota për të kryer lirshëm veprime, mes tyre dhe instalime të ndryshme software pa nevojën e një aprovimi paraprak, çfarë cenon sigurinë e të dhënave në këto pajisje dhe në rrjetin e brendshëm, sikurse përcaktohet në Standardin Ndërkombëtar të Sigurisë së Informacionit ISO/IEC 27001:2022 dhe udhëzimeve në zbatim të tij.

Kjo situatë u mundëson përdoruesve të instalojnë ose modifikojnë software pa ndonjë aprovimin paraprak nga një autoritet teknik apo drejtues, duke shmangur çdo kontroll teknik dhe duke rritur ndjeshëm rrezikun e instalimit të softuerëve të paautorizuar apo të dëmshëm.

Nga auditimi u konstatua se AAPSK nuk ka antivirus të instaluar për rrjetin kompjuterik, çfarë rrit ndjeshëm rrezikun e infektimit nga viruse, malware dhe ransomware, duke vënë në rrezik sigurinë e të dhënave dhe vazhdimësinë e proceseve të punës. Kjo mund të çojë në rrjedhje informacioni, komprometim të të dhënave të ndjeshme dhe ndërprerje të papritura të punës.

Për sa është trajtuar në këtë pikë, auditimi evidentoi nevojën për forcimin e kapaciteteve të brendshme për menaxhimin e teknologjisë së informacionit në AAPSK, përmirësimin e praktikave të regjistrimit dhe dokumentimit të aseteve, si dhe rritjen e bashkëpunimit efektiv me

strukturat përgjegjëse për asistencën teknike dhe mbështetjen IT. Këto përmirësime janë thelbësore për garantimin e sigurisë, qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të proceseve që mbështeten nga teknologjia në funksion të misionit të institucionit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione mbi Projektraportin.

2.2 Auditimi i sistemeve informatike mbi të dhënat Input/Output

Në zbatim të pikës 2 “*Auditimi i sistemeve informatike mbi të dhënat Input/Output*”, u shqyrtuan:

- Ligji nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike”;
- VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit”, i ndryshuar me vendim nr. 36, datë 24.1.2018 , me vendim nr. 448, datë 26.7.2018, me vendim nr.872, datë 24.12.2019.
- VKM nr. 835, datë 28.10.2020, “Për rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, si dhe për përcaktimin e organeve publike apo subjekteve, që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij”;
- Raporti i Auditimit të përputhshmërisë në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), publikuar në faqen web të KLSH-ës.
- Rregullorja e brendshme në AAPSK me nr. 1371/1, datë 07.06.2022;
- Rregullorja e brendshme në AAPSK me nr. 5573/3, datë 09.01.2025.

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara - AAPSK është institucioni përgjegjës për administrimin dhe/ose përdorimin e pasurive të sekuestruara me vendim të dhënë nga organet e sistemit të drejtësisë apo organet administrative, administrimin dhe/ose përdorimin e pasurive të konfiskuara, si dhe ruajtjen e provave materiale apo administrimin e tyre, sipas parashikimeve të legjislationit në fuqi. Organizimi dhe funksionimi për të gjithë stafin e agjencisë gjatë periudhës objekt auditimit është rregulluar, ndër të tjera, edhe me rregulloren e brendshme të institucionit nr. 1371/1, datë 07.06.2022. Në vitin 2025, është miratuar rregullorja e re, me urdhrin nr.01, datë 07.01.2025 për organizimin dhe funksionimin e AAPSK-së.

Nga auditimi u konstatua se në AAPSK mungon dokumentacioni bazë rregullues dhe teknik për teknologjinë e informacionit mbi të cilën mbështetet aktiviteti i institucionit, që përfshin:

- Rregullore për përdorimin dhe menaxhimin e infrastrukturës së TI-së;
- Dokumentimin e arkitekturës dhe konfigurimit të infrastrukturës teknologjike;
- Kategorizimin e informacionit të gjeneruar dhe të ruajtur nga institucioni si dhe procedurat për ruajtjen e të dhënave;
- Menaxhimin e asetëve të teknologjisë së informacionit dhe të përdoruesve;
- Përcaktimin e pikave të kontaktit për trajtimin e problematikave që hasin përdoruesit.

Mungesa e këtyre dokumenteve kufizon qartësinë operationale, vështirëson mirëmbajtjen dhe garantimin e sigurisë, si dhe cenon ruajtjen e historikut dhe auditueshmërinë e sistemeve informatike

Me VKM nr. 835, datë 28.10.2020, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e Regjistrat Elektronik të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (SPSK)”, është hartuar përmbajtja, forma, funksionimi, si dhe organet publike apo subjektet që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij.

Në përgjigjet e pyetësorëve drejtuar AAPSK, punonjësit shprehen se versioni fillestar i sistemit “Krijimi i pasaportës dixhitale për pronat e sekuestruara” është prezantuar në 12.12.2018, në

ambientet e AAPSK, ku është diskutuar mbi proceset e punës që realizohen nga AAPSK dhe pasqyrimi i tyre në sistem.

Sistemi për regjistrin elektronik të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara dhe administrimin e tyre, i quajtur Sistemi i Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara – SPSK, është instaluar nga AKSHI në vitin 2019.

Punonjësit e AAPSK-së në përgjigjet e pyetësorit të drejtuar për auditimin IT dhe gjatë intervistave mbi veprimet dhe funksionalitetet e sistemit, u shprehën se ky sistem ka patur probleme të vazhdueshme dhe nuk i ka përmbushur detyrat për marrjen e treguesve integrale që i nevojiten institucionit.

AAPSK nuk e administron kontratën e lidhur e rrjedhimisht nuk disponon:

- Informacion mbi të dhënat që do të gjenerohen prej tij.
- Të drejtat dhe detyrimet e operatorit të kontraktuar për mirëmbajtjen.
- Kohën dhe mënyrën e zgjidhjes se problemeve që janë identifikuar vazhdimisht.
- Mënyrat e raportimit dhe personat e kontaktit.

Në shtator 2023, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka publikuar raportin e auditimit të përputhshmërisë në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), linku: <https://www.klsh.org.al/raport-perfundimtar-per-auditimin-e-ushtruar-ne-agjencine-e-administrimit-te-pasurive-te-sekuestruara-dhe-te-konfiskuara/>. Një nga drejtimet e këtij auditimi ka qenë “Mbi përdorimin dhe administrimin e regjistrit elektronik të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”, trajtuar në faqet 18-22 të raportit.

Në këtë raport evidentohet fakti se AAPSK ka një sistem elektronik për mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara (SPSK), i cili nuk është funksional dhe nuk është përdorur për administrimin e pasurive. Të dhënat mbi këto pasuri janë mbajtur në formë manuale, duke rritur rrezikun për gabime dhe mungesë transparence.

Sistemi i regjistrit elektronik, shërben për organizimin e të dhënave dhe përpunimit të informacionit që krijohet dhe administrohet nga AAPSK. Bazuar në VKM nr. 835, datë 28.10.2020, përcaktohet ndërveprimi me sisteme të tjera si DPGJC, QKB, DPSHTRR dhe ASHK si dhe ofrimin e informacionit nga ky sistem për institucione të rëndësishme që citohen në pikën 14 të VKM nr. 825 datë 28.10.2020, si:

- ministri dhe sekretari i përgjithshëm i ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike ose të autorizuarit prej tyre;
- të autorizuarit e Prokurorisë së Përgjithshme;
- të autorizuarit e Prokurorisë së Posaçme;
- të autorizuarit e ministrit përgjegjës për drejtësinë;
- të autorizuarit e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave;
- të autorizuarit e Drejtorisë së Shërbimit Informativ të Shtetit.

Për periudhën objekt auditimi, informacioni i AAPSK që i nevojitet institucioneve përcaktuar në pikën 14 të VKM-së nr.835, datë 28.10.2020, komunikohet në rrugë shkresore, çfarë tregon se leximi i informacionit drejtpërdrejtë në sistem apo i statistikave raportuese, nuk është bërë i mundur, sikurse përcaktohet në pikën 15 të këtij vendimi.

Për këtë, gjatë auditimit na janë vënë në dispozicion nga punonjësit komunikime elektronike nëpërmjet email-it, për problematikat e vazhdueshme të sistemit, të cilat janë:

- Në regjistrin elektronik fshihen të dhënat e hedhura nga administratorët për pagën, shpenzimet kontratat e qirave, si dhe kur ndryshon statusin e një pasurie nga sekuestruar e konfiskuar.

- Në regjistër nuk mundet të kryhet shpenzimi i pagës së administratorit për të gjitha pasuritë, por duhet të hedhësh shpenzimin manualisht për çdo pasuri.
- Për çdo veprim duhet të shkosh tek kryefaqja pasi sistemi nuk ka opsion të kthehesh mbrapa.
- Sistemi nuk i ndan pasuritë sipas statusit “sekuestruar”, “konfiskuar”, “revokuar” etj., por i hedh të gjitha pasuritë në dritaren e pasurive të paluajtshme.
- Aplikimet për qiratë në shumë raste nuk i merr sistemi;
- Sistemi fshin pasuritë e hedhura në regjistër, si dhe vlerat monetare, të cilat duhet ti hedhësh nga fillimi.

Agjencia nuk disponon informacion të dokumentuar nëse është marrë ndonjë masë për mangësitë e sistemit nga ana e Autoritetit Kontraktor që është AKSHI.

AAPSK në mungesë të dokumentacionit historik të zhvillimit të infrastrukturës dhe sistemeve në agjenci i’u drejtua AKSHI-t për informacionet e nevojshme që i nevojiten grupit për kryerjen e auditimit. Në përgjigje të kërkesës së AAPSK-së, nga ana e AKSHI-t u dërgua një përfaqësues, në datën 10.04.2025 të cilit iu kërkua informacion mbi kontratën e sistemit SPSK, nëse ka një klasifikim të infrastrukturës ku është ngritur sistemi SPSK në zbatim të ligjit për Sigurinë Kibernetike, si dhe licencat e instaluar për windows dhe office në agjenci.

Për pyetjen drejtuar AKSHI-t nëse infrastruktura ku është ngritur sistemi SPSK, është klasifikuar si kritike apo e rëndësishme, nuk kemi marrë përgjigje.

AKSHI i komunikoi agjencisë se procedura e zhvilluar për sistemin është konfidenciale, duke sjellë në këtë mënyrë një kufizim për grupin e auditimit në dokumentacionin dhe kontratën e nënshkruar për zhvillimin, teknikalitetet dhe mirëmbajtjen e të cilit punonjësit shprehen se ka përfunduar në 2023. Përfundimi i mirëmbajtjes konfirmohet nga komunikimet elektronike me AKSHI-n, që punonjësit e agjencisë na kanë vënë në dispozicion. Në këto komunikime bëhet me dije ngritja e grupit të punës për mirëmbajtjen e sistemit, për të cilin deri në përfundim të auditimit në terren nuk ka pasur zhvillime të mëtejshme.

Punonjësit shprehën se mirëmbajtja e këtij sistemi ka përfunduar në 2023, dhe për pjesën më të madhe të periudhës objekt auditimit sistemi nuk ka qenë në funksion. Në kushtet e problematikave të vazhdueshme teknike që kanë penguar funksionimin normal të sistemit SPSK, punonjësit kanë qenë të detyruar të vijnë ushtrimin e detyrave të tyre përmes mënyrave alternative, duke përdorur tabela në Excel për regjistrimin dhe menaxhimin e të dhënave të regjistrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Kjo zgjidhje e përkohshme është ndjekur, me qëllim që të mos cenohet vazhdimësia e proceseve administrative të agjencisë.

Nisur nga ankesat e punonjësve se Microsoft Excel nuk funksionon në disa kompjuterë ku është instaluar, u kërkua informacion nëse këto produkte janë të licencuara. Duke qenë se institucioni nuk e disponon këtë informacion, ju drejtua AKSHI-t me shkresën nr.1748 prot., datë 09.04.2025, për informacion në lidhje me sistemet e operimit dhe paketat office që janë instaluar në AAPSK. Me kthim përgjigjen nr. 1604/1 prot., datë 18.04.2025, AKSHI shprehet se e ka pajisur institucionin me 45 paketa Office Pro.

Në këto kushte u vlerësua e rëndësishme që grupi i auditimit të kryente një verifikim manual në 34 kompjuterët që ka në përdorim agjencia, nisur dhe nga fakti që numri i kompjuterëve në funksion që ka agjencia është më i ulët se numri i licencave që është pajisur institucioni.

Nga auditimi u konstatua se në 7 pajisjeve kompjuterike nga 34 që ka në përdorim AAPSK, janë instaluar produkte të paketës Microsoft Office që nuk rezultojnë të licencuara, çfarë përbën një risk të lartë nga ana funksionale dhe nga ana e sigurisë. AAPSK nuk disponon asnjë dokument që vërteton licencën e instaluar dhe të drejtën e përdorimit të saj.

Dokumentim i plotë i softuerëve dhe ndalimi i përdorimit të versioneve të paligjshme është kërkesë e Standardit Ndërkombëtar të Sigurisë së Informacionit ISO/IEC 27001, standard i cili zbatohet nga AKSHI.

Në rregulloren e brendshme të AAPSK me nr.1371 prot, datë 07.06.2022, në nenin 7/pika 4 përshkruhen detyrat e specialistit për regjistrimin e të dhënave dhe sistemit informatik, detyrat dhe përgjegjësitë e të cilit janë:

- Mban evidencën e të dhënave për pasuritë e marra në administrim dhe koordinon me Specialistin e Marrjes së Administrimit të Pasurive dhe Administratorin e pasurisë, mbi evidencën e pasurive të marra në administrim të sekuestruara dhe konfiskuara në AAPSK, si dhe raporton 1 herë në muaj dhe sa herë i kërkohet nga përgjegjësi i sektorit dhe Kryeadministratori;
- Mban regjistrin e të dhënave, monitoron sistemin e të dhënave dhe koordinon me institucionet e tjera, që kanë qasje për informacionin që disponon AAPSK në përputhje me VKM-në për regjistrin e të dhënave;
- Kujdeset për sistemin dhe rrjetin informatik të AAPSK;
- Merr pjesë në komisionet e vlerësimit të çmimit për pasuritë që do të administrohen nga AAPSK, do të jepen në menaxhim nga të tretë, apo do të jepen me qira;
- Merr pjesë në komisione të tjera të ngritura me urdhër të Kryeadministratorit;
- Raporton mbi punën e kryer me shkrim tek përgjegjësi i sektorit të paktën një herë në muaj, si dhe sa herë ti kërkohet nga përgjegjësi i sektorit dhe Kryeadministratori;
- Bashkëpunon me administratorët për reklamimin e pasurive për dhënien me qira;
- Përgatit të dhënat për raporte mujore, 3 mujore dhe vjetore që sektori i dorëzon Kryeadministratorit;
- Kryen dhe detyra të tjera në funksion të AAPSK me kërkesën e përgjegjësit të sektorit apo Kryeadministratorit.

Pozicioni “*Specialist për regjistrimin e të dhënave dhe sistemit informatik*”, miratuar me rregulloren nr.1371 prot., datë 07.06.2022, është bazuar në strukturën e miratuar për AAPSK, sipas urdhrin të Kryeministrit nr. 67, datë 13.04.2022. Ky pozicion nuk është në strukturën e miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 198, datë 20.11.2023.

Nga auditimi mbi detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në rregulloren në fuqi për periudhën objekt auditimi me nr. 1371 prot., datë 07.06.2022, në pozicionin “Specialist për regjistrimin e të dhënave dhe sistemit informatik”, nuk janë adresuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi mirëmbajtja e sistemit, administrimin i të dhënave dhe rrjetit informatik të agjencisë, sipas të cilave:

- AKSHI është institucioni që administron infrastrukturën, sistemet dhe shërbimet TIK në ministritë e linjës dhe në institucionet e varësisë, përcaktuar në VKM nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar me vendimet nr. 36, datë 24.01.2018; nr. 448, datë 26.07.2018; dhe nr. 872, datë 24.12.2019.
- Mirëmbajtja e sistemit informatik që AAPSK ka pasur në përdorim gjatë vitit 2022-2023 është realizuar përmes një kontrate kofidenciale të lidhur nga AKSHI, çka përjashton delegimin e këtyre përgjegjësive tek struktura e brendshme e AAPSK-së.

Me urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr.01, datë 07.01.2025, protokolluar në AAPSK me nr.5573/3, datë 09.01.2025 është miratuar rregullorja e re për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

Në nenin 15 të rregullores së brendshme përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e pozicionit “Specialist për çështjet juridike, përditësimin dhe mirëmbajtjen e sistemit”, ku përfshihet edhe detyrimi për mirëmbajtjen dhe përditësimin e sistemit elektronik të agjencisë.

Nga auditimi u konstatua se në rregulloren e brendshme miratuar me urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr.01, datë 07.01.2025, protokolluar në AAPSK me nr. 5573/3, datë 09.01.2025, nuk janë përcaktuar detyra dhe përgjegjësi për kryerjen e një kopje rezervë për të dhënat elektronike që ruhen lokalisht tek çdo përdorues, megjithëse rëndësia e tyre është shumë e lartë për aktivitetin e institucionit. Mungesa e një kopje rezervë përbën risk në disponueshmërinë e të dhënave, humbjen dhe pamundësinë për rikuperim, në rast të incidenteve teknike, bazuar në praktikat më të mira të sigurisë së informacionit.

Nga auditimi u konstatua se detyrat për përditësimin dhe mirëmbajtjen e sistemit nuk mund të realizohen në praktikë nga pozicioni “Specialist për çështjet juridike, përditësimin dhe mirëmbajtjen e sistemit”, përcaktuar në nenin 15 të rregullores së brendshme. Ky pozicion është plotësuar me një punonjës me formim juridik, ndërkohë që i janë ngarkuar edhe detyra teknike që nuk përputhen me profilin profesional. Në një nga detyrat përfshihen edhe konfigurimet e sistemit SPSK, si: vendosja e organogramës, krijimi i përdoruesve dhe roleve, përcaktimi i statuseve të pasurive, regjistrimi i institucioneve, njësisive matëse dhe konfigurimi i llogarive sipas Regjistrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (RPSK).

Për sa është trajtuar në këtë pikë, auditimi evidentoi se AAPSK përballet me mangësi të dokumentacionit teknik dhe rregullator për teknologjinë e informacionit, si dhe me mosfunksionimin e sistemit elektronik SPSK për administrimin e pasurive. Sistemi nuk ka shërbyer si mjet i sigurtë për popullimin me të dhëna dhe ndjekjen e proceseve operacionale të agjencisë për administrimin e regjistrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, mungon mbështetja teknike dhe dokumentare, çfarë ka detyruar punonjësit të përdorin mjete alternative si Excel. Mangësitë e cituara më sipër, tregojnë për dobësi në menaxhimin e TI-së dhe përbëjnë rrezik për qëndrueshmërinë e veprimeve operacionale të institucionit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione mbi Projektraportin.

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se, në mungesë të IT si strukturë në institucion apo suportit nga IT e Ministrisë së Brendshme/AKSHI, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara, nuk ka patur një suport të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm për problematika të teknologjisë së informacionit, duke u mbështetur kryesisht në njohuritë bazë të punonjësve për menaxhimin e aseteve TIK. Kjo situatë cenon sigurinë, integritetin dhe efikasitetin e proceseve të automatizuara të punës, duke rritur mundësinë e gabimeve njerëzore, konfigurimeve të pasakta dhe vonesave në adresimin e incidenteve. Aktualisht për problematika në fushën TIK institucioni suportohet nga specialisti për dixhitalizimin e arkivës së AAPSK me kontratë të përkohshme 1 (një) vjeçare, në zbatim të vendimit nr. 395, datë 29.4.2015 “Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 7-11 të Raportit të Auditimit)

Rekomandimi: Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të marrë masa për miratimin e një strukture të përhershme për teknologjinë e informacionit, si dhe të bashkëpunojë me Ministrinë e Brendshme dhe Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për mbështetje të strukturave të IT-së, për zgjidhjen në kohë dhe me profesionalizëm të problematikave që lidhen me teknologjinë e informacionit.

Brenda vitit 2025

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se të gjithë përdoruesit i aksesojnë kompjuterët si administrator lokal, me të drejta të plota për të kryer lirshëm veprime, mes tyre dhe instalime të ndryshme software pa nevojën e një aprovimi paraprak, çfarë cenon sigurinë e të dhënave në këto pajisje dhe në rrjetin e brendshëm, sikurse përcaktohet në Standardin Ndërkombëtar të Sigurisë së Informacionit ISO/IEC 27001:2022 dhe udhëzimeve në zbatim të tij. Kjo situatë u mundëson atyre të instalojnë ose modifikojnë software pa aprovimin paraprak nga një autoritet teknik apo drejtues, duke shmangur çdo kontroll teknik dhe duke rritur ndjeshëm rrezikun e instalimit të softuerëve të paautorizuar apo të dëmshëm.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 7-11 të Raportit të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, të marrin masa për kufizimin e të drejtave të përdoruesve, duke hequr aksesin e panevojshëm si administrator lokal dhe duke implementuar parimin e privilegjit minimal, që përdoruesit të kenë vetëm të drejtat e nevojshme për kryerjen e detyrave të tyre, ndërsa instalimi i softuerëve duhet të jetë i kontrolluar dhe të kryhet vetëm nga personeli i autorizuar.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se nuk ka antivirus të instaluar për rrjetin kompjuterik të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara, sikurse përcaktohet në Standardin Ndërkombëtar të Sigurisë së Informacionit ISO/IEC 27001:2022. Mungesa e një mbrojtjeje të tillë e ekspozon institucionin ndaj rrezikut të infektimit nga viruse, malware dhe ransomware, duke rrezikuar sigurinë, konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave, si dhe duke cenuar vazhdimësinë e proceseve të punës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 7-11 të Raportit të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, të marrin masa për mbrojtjen nga viruset në të gjitha pajisjet e rrjetit kompjuterik të institucionit me qëllim mbrojtjen e të dhënave.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se dokumentimi i aseteve TIK në AAPSK është i paplotë dhe jo i përditësuar në përputhje me praktikën më të mira. Nuk figurojnë në regjistrat qendrorë të aseteve dhe kartelat personale dhe as të regjistruara se ku janë instaluar 45 licencat e Microsoft Office të siguruara nga AKSHI. Për më tepër, numri i licencave tejkalon numrin e pajisjeve kompjuterike në ka në përdorim agjencia prej 34 kompjuterësh. Gjithashtu, nuk ekziston asnjë gjurmë dokumentare që tregon regjistrimin si asete apo në përdorim të pajisjeve fizike të rrjetit si router, switch etj. Mungesa e dokumentacionit vë në rrezik menaxhimin e aseteve dhe vazhdimësinë e punës sipas përcaktimeve në standardin ISO/IEC 27001 dhe praktikën më të mira.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 7-11 të Raportit të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara në bashkëpunimin me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit të identifikojnë pajisjet fizike të sistemit informatik, vendet ku janë instaluar dhe dokumentojë ato, për regjistrimin e tyre si asete të institucionit apo në përdorim të tij, gjithashtu edhe licencat për softuerë të dhëna për përdorim nga ky institucion.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në AAPSK mungon dokumentacioni bazë rregullues dhe teknik për teknologjinë e informacionit mbi të cilën mbështetet aktiviteti i institucionit, që përfshin:

- Rregullore për përdorimin dhe menaxhimin e infrastrukturës së TI-së;
- Dokumentimin e arkitekturës dhe konfigurimit të infrastrukturës teknologjike;
- Kategorizimin e informacionit të gjeneruar dhe të ruajtur nga institucioni si dhe procedurat për ruajtjen e të dhënave;
- Menaxhimin e aseteve të teknologjisë së informacionit dhe të përdoruesve;
- Përcaktimin e pikave të kontaktit për trajtimin e problematikave që hasin përdoruesit.

Mungesa e këtyre dokumenteve kufizon qartësinë operationale, vështirëson mirëmbajtjen dhe garantimin e sigurisë, si dhe cenon ruajtjen e historikut dhe auditueshmërinë e sistemeve informatike, dhe në kundërshtim me kërkesat e standardit ISO/IEC 27001.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 11-15 të Raportit të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara në bashkëpunimin me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, të hartojë dhe miratojë dokumentacionin bazë rregullues dhe teknik për teknologjinë e informacionit ku bëjnë pjesë rregullore, infrastruktura, kategorizimi dhe ruajtja e të dhënave, menaxhimin e aseteve të teknologjisë së informacionit si dhe pikat e komunikimit për trajtimin e problematikave të një niveli më të avancuar teknik.

Brenda vitit 2025

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në 7 pajisjeve kompjuterike nga 34 që ka në përdorim AAPSK, janë instaluar produkte të paketës Microsoft Office që nuk rezultojnë të licensuara, çfarë përbën një risk të lartë nga ana funksionale dhe nga ana e sigurisë. AAPSK nuk disponon asnjë dokument që vërteton se produktet e instaluar dhe e drejta e përdorimit të tyre është e licensuar. Dokumentim i plotë i softuerëve dhe ndalimi i përdorimit të versioneve të paligjshme është kërkesë e Standardit Ndërkombëtar të Sigurisë së Informacionit ISO/IEC 27001, standard i cili zbatohet nga AKSHI.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 11-15 të Raportit të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, të marrin masa të

menjëhershme për verifikimin, legalizimin ose zëvendësimin e produkteve të palicensuara të paketës Microsoft Office, të instaluara në pajisjet kompjuterike të institucionit.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në rregulloren e brendshme miratuar me urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr.01, datë 07.01.2025, protokolluar në AAPSK me nr.5573/3, datë 09.01.2025, nuk janë përcaktuar dhe adresuar detyra dhe përgjegjësi për ruajtjen e të dhënave me kryerjen e një kopje rezervë për të dhënat elektronike që ruhen lokalisht tek çdo përdorues, megjithëse rëndësia e tyre është shumë e lartë për aktivitetin e institucionit. Mungesa e këtij procesi rrit riskun për humbje të të dhënave dhe pamundësi rikuperimi në rast incidentesh teknike, dhe në mospërputhje me kërkesat e **nenit 5 dhe nenit 8 të Ligjit nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”**, ku kërkohet mbrojtja e informacionit dhe garantimi i sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm.

Nga auditimi mbi detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në rregulloren në fuqi për periudhën objekt auditimi me nr. 1371 prot., datë 07.06.2022, u konstatua se mirëmbajtja e sistemit, administrimin i të dhënave dhe rrjetit informatik të agjencisë nga pozicioni “Specialist për regjistrimin e të dhënave dhe sistemit informatik”, nuk janë adresuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, sipas të cilave AKSHI është institucioni që administron infrastrukturën, sistemet dhe shërbimet TIK në ministrinë e linjës dhe në institucionet e varësisë, përcaktuar në VKM nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar me vendimet nr. 36, datë 24.01.2018; nr. 448, datë 26.07.2018; dhe nr. 872, datë 24.12.2019.

Mirëmbajtja e sistemit informatik që AAPSK ka pasur në përdorim gjatë viteve 2022-2023 është realizuar përmes një kontrate konfidenciale të lidhur nga AKSHI, si rrjedhojë përjashtohet delegimi i këtyre përgjegjësive tek struktura e brendshme e AAPSK-së.

Me urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr.01, datë 07.01.2025, protokolluar në AAPSK me nr.5573/3, datë 09.01.2025, është miratuar rregullorja e re për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë, ku në nenin 15 përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e pozicionit “Specialist për çështjet juridike, përditësimin dhe mirëmbajtjen e sistemit”, ku përfshihet detyrimi për mirëmbajtjen dhe përditësimin e sistemit elektronik të agjencisë.

Nga auditimi u konstatua se detyrat për përditësimin dhe mirëmbajtjen e sistemit nuk mund të realizohen në praktikë nga pozicioni “Specialist për çështjet juridike, përditësimin dhe mirëmbajtjen e sistemit”, pasi ky pozicion është plotësuar me një punonjës me formim juridik, ndërkohë që i janë ngarkuar edhe detyra teknike që nuk përputhen me profilin profesional, në kundërshtim me nenin 15 të rregullores së brendshme.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 11-15 të Raportit të Auditimit)

7.1 Rekomandimi: Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, të rishikojë dhe përditësojë rregulloren e brendshme të funksionimit, në mënyrë që detyrat dhe përgjegjësitë për përditësimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të jenë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Sistemi elektronik për menaxhimin e regjistrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara - SPSK, është regjistruar si bazë të dhënash shtetërore me VKM nr. 835, datë 28.10.2020. Ky sistem është instaluar nga AKSHI në vitin 2019, me mirëmbajtje për 4 vjet (kontratë e klasifikuar), dhe AAPSK nuk disponon asnjë informacion mbi afatet, kriteret dhe vlerën e zbatimit të kësaj kontrate. Mos përdorimi i këtij sistemi është konstatuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe në Auditimin e Përputhshmërisë ku është rekomanduar vënia në përdorim dhe përditësimi i regjistrimit elektronik të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, publikuar në linkun:

<https://www.klsh.org.al/raport-perfundimtar-per-auditimin-e-ushtruar-ne-agjencine-e-administrimit-te-pasurive-te-sekuestruara-dhe-te-konfiskuara/>.

Gjatë periudhës objekt auditimi, ky sistem nuk qenë funksional dhe nuk është përdorur në praktikë për kryerjen e proceseve të administrimit të pasurive.

Punonjësit e AAPSK-së kanë përcjellë tek AKSHI probleme të rëndësishme dhe të vazhdueshme të mosfunksionimit të sistemit, megjithatë situata vazhdon të jetë e njëjtë.

Gjatë periudhës objekt auditimi, punonjësit e agjencisë kanë vijuar të punojnë për regjistrimin dhe menaxhimin e të dhënave të regjistrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara me tabela Excel si një mënyrë alternative, për arsye të problematikave që kanë penguar jo vetëm përdorimin dhe administrimin e tij, por dhe në qasjen në informacion të subjekteve sipas përcaktimeve në VKM nr. 835, datë 28.10.2020.

Për sa më lart, fondet e investuara për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit elektronik emërtuar “regjistri i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”, janë pa efektivitet dhe efikasitet.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 11-13 të Raportit të Auditimit)

8.1 Rekomandimi. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara si Autoritet Përfitues, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit si Autoritet Kontraktor, të marrin masa për zgjidhjen e mangësive funksionale të vazhdueshme që kanë penguar përdorimin dhe vënien në funksion të sistemit elektronik për regjistrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

Menjëherë

Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT